

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Banush Pacolli, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6 par.1 dhe 2 i sanksionuar me nenin 16 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, e në bazë të nenit 73, 74, dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 27.10.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Banush Zymer Pacolli ,i lindur me 07.03.1968 ne fsh.Marevc ,me vendbanim ne fsh.Hajvali KK Prishtine,i martuar ,prind i tre femijeve,ka te kryer fakultetin, me profesion inxhinier, dhe jeton ne gjendje te mesme ekonomike.

E s h t e p e r g j e g j e s

Sepse ne cilesine e zyrtarit te larte si Antar i bordit te drejtoareve ne Ndermarrjen Publike Banesore ne Prishtine , nuk e ka bere deklarimin e pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit,ne afatin e parapare ligjor gjegjesisht deri me daten 31.03.2011. Me veprim te ketille ka kryer kundervajtje nga neni 6 par 1 dhe 2 i sanksionuar me nenin 16 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, andaj per kete,

G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 300 (treqind) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e te hyrave te KGJK-se, No.1000 4300 7000 0518.Pagesa behet ne ndonjeren agjensi per mbledhjen e te hyrave -banke,permes urdherpageses te plotesuar nga gjykata .Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi.

Shpenzime te procedures nuk ka patur,kurse ne emer te paushallit gjyqesor i pandehuri eshte i obliguar te paguaje shumen prej 5(pese) €,ne sherbimin e arkes se gjykates. Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjensia Kunder Korrupsionit,Prishtine parashtroi kërkesen me nr.01/3192/11 më dt. 19.07.2011 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër pandehurit te cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Ne baze te kerkeses se parashtuar u inicua procedura kundervajtese me marrjen ne pyetje te pandehurin ,i cili e pranoi kundërvajtjen e cila me kerkese i vihet ne barre dhe shton se gjate kohes sa eshte dashur qe ta kryeje kete obligim i njëjti ka qene jashte vendit. Ne baze te te dhenave ne kerkese,deklarates se te pandehurit, shqimit te shkresave te lendes dhe provave tjera te administruara gjate procedures, Gjykata konstatoi se i pandehuri e ka kryer kundervajtjen e cila me kerkese i vihet ne barre,per eka u shpall pergjegjes dhe u denua me gjobe si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA OF KOSOVO		AGJENSIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	DPK/DMP	Br. Prot.	03-1726/2012
Nr. i faq.		Prot No.	
Broj stranica	02	Data	11.05.2012
Nr. pages		Datum	
PRISHTINE			

11/29/2012/02
feng

Me rastin e shqiptimit te denimit ,konform nenit 7 te LMK,se ,u moren parasysh te gjitha rrethanat e kryerjes se kundervajtjes,dhe te pandehurit iu shqiptua denimi me gjobe ne lartesine si ne dispozitiv ,duke konsideruar se edhe me kete do te arrihet efekti i sanksionimit ,ashu qe i pandehuri ne te ardhmen tu shmanget kryerjes se veprave te tilla apo te ngjashme kundervajtese .

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrojë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës,Gjykates se Larte per Kundervajtje, në afatin prej 8 ditësh,pas marrjes se ketij aktvendimi,nepermes kesaj gjykate dhe pa taksa

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Gjyqtarja
Zajrete Muhaxheri

